

VENDIM
Nr.1206, datë 11.12.2009

PËR NJË SHITESË E NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1114, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, NR. 9136, DATË 11.9.2003 “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE, SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, DHE NR.7870, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7983, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e tokës bujqësore, livadheve dhe kullotave", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa e ndryshimi, si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 6 të kreut IV, "Procedurat për regjistrim", shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Njihen periudha sigurimi për efekt të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”:

a) periudhat, nga data 1.10.1993 deri në datë 1.5.2004, për të cilat, të vetëpunësuarit në bujqësi kanë paguar kontribute deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, pavarësisht nga vendbanimi në kohën e kryerjes së pagesës.

b) periudhat nga data 1.9.1995 deri në datë 1.5.2004, për të cilat, të vetëpunësuarit në bujqësi kanë paguar kontribute deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, pavarësisht nga vendbanimi në kohën e kryerjes së pagesës, për rastet, kur toka është blerë, sipas ligjit nr.7983, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e tokës bujqësore, livadheve dhe kullotave”, si dhe për rastet, kur toka është marrë me qira, me akt noterial.

Për njohjen e periudhave të sigurimit shoqëror, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, të vetëpunësuarit në bujqësi duhet të paraqesin këto dokumente:

i) Vërtetimin nga komuna/ bashkia se i interesuari ka tokë në pronësi ose në përdorim, duke cilësuar dhe datën, kur është përfituar kjo tokë.

ii) Certifikatën e gjendjes civile (në rastet e largimit, të shënohet dhe data e çregjistrimit nga regjistri i gjendjes civile).

iii) Vërtetimin nga komuna/bashkia se për këtë periudhë ka ushtruar veprimtari, bujqësore e blegtorale.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore nxjerr aktet për trajtimin e të gjitha kërkesave të refuzuara për pension, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.”.

2. Pika 8 e kreut IV, “Procedurat për regjistrim”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Kryefamiljarët, që punësojnë persona, si punëtorë shtëpie, i rregullojnë marrëdhëniet e punës, nëpërmjet një kontrate me shkrim, ndërmjet palëve, ku përveç të tjerave shënohen, detyrimisht, numri i sigurimit shoqëror të personit të punësuar, koha e fillimit të punës, zgjatja e saj “me ose pa afat”, si dhe paga mujore bruto. Në këtë rast, kryefamiljari përcaktohet në rolin e

punëdhënësit dhe dhe si i tillë ka detyrimin për regjistrim në organet tatimore dhe për pajisjen nga këto organe me numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT-i). Regjistrimi dhe çregjistrimi nga organet tatimore bëhen sipas një procedure të thjeshtuar, që përcaktohet me udhëzim nga Ministri i Financave.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha